

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

«Space Travel Albania » Sh.p.k.

Ne Tirane, sot me daten 04.07.2022

Znj.Vjollca Malaj, atesia Myfit , lindur me 16.06.1965 ne Kelcyre, Permet , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit Nr.035967859.

Vendos sa vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria «**Space Travel Albania » Sh.p.k.** , nga Ortak te vetem themelues:

Znj.Vjollca Malaj, atesia Myfyt , lindur me 16.06.1965 ne Kelcyre, Permet , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit Nr.035967859.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne adresen:

Rr. « Kostaq Cipo » ,P 6, Sh. 6, Tirane

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim te ortakut te vetem, mund te krijohen ose anulohen seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise si dege apo perfaqesi edhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

NENI 4

Kapitali i shoqerise

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, formuar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem i shoqerise, i ndare ne 1 Kuota, me vlere nominale 1 kuote / 100000 leke, i depozituar sipas ligjit dhe perkatesisht i ndare ne Pjese te Kapitalit si me poshte:

Znj.Vjollca Malaj, atesia Myfyt , lindur me 16.06.1965 ne Kelcyre, Permet , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit Nr.035967859.

zoteron 100 % (Njeqid perqind) te kuotave te kapitalit themeltar, nje kuote e barabarte me 1 kuote / 100,000 leke.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme. Ortaku i vetem mund te shese kuotat e tij personave te trete ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te aplikuar dhe parshikimeve te

statutit të kësaj Shoqërie.

Transferimi i Kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe përgjithësisht siç parashihet në ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve. Në rastet e bashkëpronësisë veprohet në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Kapitali mund të rritet me zhvillimin e veprimtarisë ekonomike financiare të shoqërisë dhe me investime personale të ortakut.

Ortaku i vetëm ka të drejtë pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është me një afat të pa përcaktuar.

NENI 6

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi , në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Shoqëria çel llogari bankare në monedhë shqiptare si edhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaku i vetëm i Shoqërisë ose Administratori i emëruar prej tyre, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria bankare.

NENI 8

Ortaku i vetëm, ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributet e tij përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themelor, Transferimet duhet të jenë të vertetuara me Akti Notarial dhe për një gjë të tillë duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim Asambleja e Ortakëve.

Shoqëria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo tu behen të ditura.

NENI 9

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë :

- Operator Turistik

NENI 10

Me vendim të Ortakut të vetëm shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarvajtjen e shoqërisë.

NENI 11

Me vendim të Ortakut të vetem, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 12

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për Shoqëritë Tregtare" i njeh asamblese së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortaku i vetem mund t'i delegojnë kompetencat një ose me shumë administratorëve të caktuar prej tij ose dhe një personi fizik jashtë shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës.

NENI 13

Administratori i shoqërisë emërohet **Znj. Vjollca Malaj**.

Afati i emerimit të administratorit është 3 vjet.

Administratori i shoqërisë gëzon të gjitha të drejtat që ligji «Për Shoqëritë Tregtare» parasheh, pa asnjë kufizim të kompetencave.

Administratorët emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve.

NENI 14

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQËRISË TREGTARE

«Space Travel Albania» Sh.p.k.

Znj. Vjollca Malaj

